REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 350/19
Datë/Datum. 11.07.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	• Zyrtari përgjegjës i prokurimit, **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK** Operatori Ekonomik ankues: • "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	**Shefkinaze Villasaliu** – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	**Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me nr. 350/19 të parashtruar nga tenderuesi,** "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci		
Datë	09.07.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt: 27.06.2019 me nr. 350/19 të parashtruar nga tenderuesi, "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci, lidhur me aktivitetin prokurimit,

Titulli: MASAT PREVENTIVE-INTERVENIME EMERGJENTE NE OBJEKTE SHTEPI NE PRIZREN - **Shtëpia e Familjes Dukagjini, Muriqi, Hereni, Koci, Kolshi, Skenderi, Doda dhe Lokvica,** me nr. të prokurimit: **207-19-1586-5-2-1** dhe Numri i brendshëm: **207-19-012-5-2-1,** i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- Tenderuesit ankues: "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

RAPORTI I *EKSPERTIT SHQYRTUES*

		10.06.2019	**08.07.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

1) Me datën: 27.06.2019 tenderuesi "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit MASAT PREVENTIVE-INTERVENIME EMERGJENTE NE OBJEKTE SHTEPI NE PRIZREN - **Shtëpia e Familjes Dukagjini, Muriqi, Hereni, Koci, Kolshi, Skenderi, Doda dhe Lokvica,** me nr. të prokurimit: 207-19-1586-5-2-1 dhe Numri i brendshëm: 207-19-012-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues(AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të Tenderuesit ankues.

Tenderuesi Ankues, "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci

Tenderuesi ankues, "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci", pretendon se AK-MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK përmes Komisionit për vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje te dispozitave të *Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (më tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së dhe atë konkretisht*:

Nenit 1, *Qëllimi*

Nenit 6, *Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*

Nenit 7, *Barazia në trajtim/Jo diskriminimi*

Neni 59, *Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi* dhe

Neni 60, *Kriteret pre Dhënien e Kontratës*

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

3.-Një pasqyrë tabelare e personelit të kërkuar Emrin, mbiemrin ,mosha e punëtorit, profesioni i kërkuar si dhe eksperienca duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.

KERKESA 4. Ne listën e stafit te prezantojë -2(DY) Inxhinier te diplomuar te Arkitekturës, me min 5 vite përvojë pune ne angazhime profesionale ne objektet e trashëgimisë kulturore (sistem pese vjeçar ose master) -1Një Inxhinier të Ndërtimtarisë-Drejtimi Konstruktiv, min. 5 vite përvojë. (sistem pese vjeçar ose master)

- Mjeshtrin e punëve te drurit --- -Mjeshtërinë e punëve te gurit

4.1.Inxhinierat e Arkitekturës dhe inxh e ndërtimtarisë te posedojnë Diplomën, CV-ja e përshkruar qarte me eksperiencën e kërkuar, e nënshkruar dhe referencat, kopja e kontratës së punës e vlefshme_ para kontratë, si dhe 2 referencat ne objektet restauruese qe dëshmojnë përvojën e kërkuar 5 vjeçare -Mjeshtri i punëve te drurit te dokumentohen me kontrata para kontrata dhe 2 referenca te punëve te kryera te kësaj natyre (angazhime profesionale ne objektet e Trashëgimisë Kulturore) -Mjeshtri punëve te gurit te dokumentohen me kontrata para kontrata dhe 2 referenca te punëve te kryera te kësaj natyre (angazhime profesionale ne objektet e Trashëgimisë Kulturore)

Vërejtje stafi profesional, Inxh. arkitekturës nuk pranohen me Bachelor

OE FITUES ALBOOS, SUHAREKE – I PAPERGJEGJSHEM

z. Bujar Prestreshi nuk është në Listën e stafit të prezantuar nga OE fitues siç është kërkuar në pikën 3 dhe 4 andaj nuk është plotësuar kërkesa e AK MKRS

OE fitues ka bërë kontratë mbi vepër për projektin në fjalë me z. Bujarin më datën 23/04/2019 z. Bujar Prestreshi është i diplomuar më datën 11/04/2005 i cili ka marr titullin inxhinier i diplomuar i Arkitekturës.

CV e dorëzuar për z Bujar Prestreshi nuk është e përshkruar qartë me eksperiencën e kërkuar siç është kërkuar në pikën 4.1, pasi që në CV-in e dorëzuar nuk përshkruhet asgjë për projektet e trashëgimisë kulturore se në cilët projekte të trashëgimisë ka punuar në CHWB z Bujari, andaj OE fitues nuk ka plotësuar kriterin i kërkuar nga AK MKRS me z Bujar Prestreshin

z. Prestresit Arch i diplomuar nuk ka 2 referenca që dëshmojnë përvojën e punës 5 vjeçare në objektet restauruese të trashëgimisë kulturore siç është kërkuar në piken 4.1 FTD pasi qe kërkesa nga AK MKRS është se duhet të ofrohen 2 referenca në objektet trashëgimisë që të mbulohet përvoja e punës min 5 vite

në objektet e trashëgimisë. Në CV-in e z Bujarit është shënuar se ka punuar në Swedish NGO ChwB në vitin 2002-2007 por nuk ka të dhëna se në cilat projekte ka punuar në objektet e trashëgimisë kulturore , gjithashtu ju sqarojmë se z.Bujari ka diplomuar më datën 11/04/2005 që do të thotë nga viti 2002-2005 nuk e ka pasur titull Ingjinier i diplomuar i Arkitekturës, andaj përvoja e punës nuk është e pranueshme si përvojë e punës nga viti 2002-2005 pasi që nuk e ka pasur titullin e fituar të Ingjinier i Arkitekturës bazuar me ligjet ne Kosovë, andaj z Bujari ka përvojë punë në objektet e trashëgimisë vetëm 2 vite pas marrjes se titullit te Inxhinierit te Arkitekturës po ashtu për z. Bujarin mungojnë 2 referencat nga punëdhënësi që dëshmojnë përvojën e punën 5 vjeçare në objektet e trashëgimisë Referencat tjera tę përvojës së punës të dorëzuar për z Bujar nuk janë referenca që dëshmojnë përvojën e punës min 5 vjeçare në objektet e trashëgimisë kulturore.

z. Isuf Hoxha me diplomë Master profesional ne Dizajn Urban dhe Peizazhi të lëshuar më datën 07/12/2017,

z.Isuf Hoxha nuk është në Listën e stafit të prezantuar nga OE fitues siç është kërkuar në pikën 3 dhe 4 andaj nuk është plotësuar kërkesa e AK MKRS

OE fitues ka bërë kontrate mbi vepër për projektin në fjalë me z. Hoxha më datën 23/04/2019

Isuf Hoxha me diplomë Master professional ne Dizajn Urban dhe Peizazhi të lëshuar më datën 07/12/2017, ndërsa në CV-in e z Hoxha nuk ka të dhëna rreth diplomimit në Universitetin e Prishtinës Fakulteti Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.

CV-ja e dorëzuar me z Hoxha nuk është përshkruar qartë me eksperiencën e kërkuar siq është kërkuar në pikën 4.1, pasi që në CV-in e dorëzuar nuk përshkruhet asgjë për projektet e trashëgimisë kulturore të cilën z Hoxha ka punuar në projekt të trashëgimisë kulturore, andaj OE fitues nuk plotësuar kriterin e kërkuar nga AK MKRS me z Hoxha-j

z.Hoxha Master profesional ne Dizajn Urban dhe Peizazhi nuk ka 2 referenca që dëshmojnë dhe mbulojnë përvojën e punës 5 vjeçare në objektet restauruese apo të trashëgimisë kulturore siç është kërkuar në pikën 4.1 FTD pasi që kërkesa nga AK MKRS është se duhet të ofrohen 2 referenca në objektet trashëgimisë që të dëshmohet përvoja e punës min 5 vite.

Z, Xhevdet Buqa, me titull Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë Konstruktive i diplomuar me 12/07/2006 i punësuar me kontratë të rregull e lidhur në mes palëve më dt 28/04/2016 dhe sipas përshkrimit tę CV—së është që z Buqaj punon në kompaninë Alboss nga viti 2011 dhe vazhdon. Sipas Referencës së lëshuar nga Alboss nuk ka informata se cilën periudhë ka punuar z Buqaj në këtë kompani, Në reference janë përshkruar këto projekte që z Buqaj ka punuar : 4.Restuarimi i kompleksit te Lidhjes Shqiptare te Prizrenit e lidhur me daten 18/05/2018 nr 89- 9/2018 dhe vlera 38.444.00 € me QRTK, Prizren, dhe referenca e lëshuar me dt 17/12/2018.

2.Restuarimi i shtëpisë se familjes Shpejti (Fasadimi i objektit) e lidhur me datën 26/04/2018 nr 155/2018 me vlere 7,848.40 € me QRTK, Prizren dhe Referenca e lëshuar me dt 17.12.2018 3. Masat preventive-Ndërhyrjet emergjente Objekti Shtëpia e familjes Drini faza I, e lidhur 19/10/2017 me nr 357/2017 ne vlerë 8,982.50 €, me QRTK Prizren dhe Referenca e lëshuar me datën 17/12/2018.

4. Masat preventive-Ndërhyrjet emergjente Objekti Shtëpia e familjes Ukallo, e lidhur 19/10/2017 me nr 357/2017 ne vlerë 9,995.70 €, me QRTK Prizren dhe Referenca nuk ka për këtë projekt

Sipas të dhënave të kontratave dhe referencave të projekteve të realizuar nga OE Alboss vërtetohet se ka realizuar kontrata të natyrës së trashëgimisë kulturore në vitet 2017 dhe 2018 Andaj projektet e cekura në reference nga Alboss për z Buqa dhe sipas listës së projekteve dhe kontratave dhe reference të

dorëzuar në dosjen e tenderit të OE Alboos dëshmohet se ka përvojë punë vetëm 1 apo 2 vite në projekt e trashëgimisë kulturore, andaj z Buqa nuk ka plotësuar kriterin e kërkuar që të dëshmojë përvojën e punës min 5 vjeçare në objektet e trashëgimisë, gjithashtu është ofruar vetëm një reference dhe jo siq është kërkuar në pikën 4 qe të ofrohen 2 referenca, ku 2 referencat në objektet e restauruese që dëshmojnë dhe të mbulojnë përvojën e kërkuar 5 vjeçare, sipas kërkesës 4.1.

Andaj për z Buqaj nuk ka dy referenca gjithashtu nuk dëshmohet se ka përvojë punë në objektet e trashëgimisë min 5 vite me 2 referenca nga punëdhënësi.

Z, Isuf Dakaj, mjeshter i gurit me kontratë të rregullt më datën 01/06/2018, ka të dëshmuar vetëm një referencë të lëshuar nga OE Alboss më datën Prizren 2019, ndërsa në kërkesën 4.1 nga AK-se MKRS është kërkuar 2 referenca të punëve të kryera të kësaj natyre (Angazhime profesionale ne objektet e trashëgimisë kulturore, andaj nuk është plotësuar kriteri i përcaktuar nga OE fitues për mjeshtrin e gurit me z Dakaj pasi që nuk janë ofruar 2 referenca siç është kërkuar kriteri nga MKRS.

z. Shaban Thaci, mjeshter latues, me kontratë të rregullt më datën 28/04/20196, ka të dëshmuar vetëm një referencë të lëshuar nga OE Alboss më datën Prizren 2019, ndërsa në kërkesën 4.1 nga AK-se MKRS është kërkuar 2 referenca të punëve të kryera të kësaj natyrë (Angazhime profesionale në objektet e trashëgimisë kulturore, andaj nuk është plotësuar kriteri | përcaktuar nga OE fitues për mjeshtrin e drurit z Thaqi pasi që nuk janë ofruar 2 referenca siç është kërkuar.

Bazuar se z Prestreshi dhe z Hoxha dhe z Buga, z.Dakaj, z Thaqi_sipas përshkrimit të lartë cekur nuk i kanë plotësuar kërkesat te pikës_ 3 dhe 4 të përcaktuar në FTD Kapaciteti teknik dhe profesional pika 3 dhe 4 nga AK MKRS,andaj konstatohet se OE fitues Alboss nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuar në FTD andaj AK_MKRS në kundërshtim me nenin 60 LPP _ka shpërblyer me tender OE Alboss i cili është i pa përgjegjshëm.

OE N.P.N. "IDEA PROJECT", DEÇAN-I PA PËRGJEGJSHËM

z. Fatos Sahatqija, Është i diplomuar me 24/06.1989 dhe ka marre titullin inxhinjer i Arqitektures.

Tenderuesi N.P.N. "Idea Project" ka bërë kontratë mbi vepër për projektin në fjalë me Sahatqija më datën 19/04/2019.

z. Fatos Sahatqija, i Mungon CV-ja e përshkruar qartë me eksperiencën e kërkuar, e nënshkruar andaj CV-ja nuk është dorëzuar fare në dosjen e tenderit nga OE N.P.N. "Idea Project", gjiashtu nuk janë dëshmuar fare 2 referenca nga punëdhënësi në objektet restauruese që dëshmojnë përvojën e kërkuar 5 vjeçare në objektet e trashëgimisë kulturore siç është kërkuar në pika 4.1 të FTD nga AK-se MKRS

Andaj z Sahatqija nuk plotëson kriterin e përcaktuar nga AK —se MKRS pasi që mungon CV-ja po ashtu mungojnë 2 referenca nga punëdhënësi që dëshmojnë se ka përvojën të punës në objektet e trashëgimisë 5 vjeçare të kërkesa pika 3 dhe 4,1 FTD.

Ferdeze Sermaxha është i diplomuar më datën 23/05/2008 e cila ka marr titullin inxhinier i diplomuar i Arkitektures OE N.P.N. "Idea Project" ka kontrate mbi vepër për projektin në fjalë me Sermaxhaj më

datën 19/04/2019 Sipas CV -së Ferdeze Sermaxha e cila është përshkruar se punon të OE N.P.N. "Idea Project" nga viti 2015 dhe ka punuar në këto projekte dhe sipas referencës së lëshuar nga OE N.P.N. "Idea Project" më datën 03/05/2018 : Kulla e Salih Kajtazit,Kicic i vogël dhe

Kulla e Asllan Tupella Kicic i Vogël, viti 2017, vlera e kontratës 24,973.57 €

Objekti-Shtëpia e banimit Mirsad Ferati, viti 2017, vlera e kontratës 11,440.08 €

Objekti Sahat Kulla — Gjilan, viti 2017, vlera e kontratës 33,236.61 €,

Sipas Projekteve të cekura në CV dhe Referencën e lëshuar punëdhënësi N.P.N. "Idea Project" po konstatohet se Ferdeye Sermaxha nuk ka dëshmi se ka përvojë pune 5 vjeçare ne objektet e trashëgimisë kulturore, pasi që sipas projekteve të cekur dhe listës së kontratave te OE NNP Ideja project te realizuar gjate vitit 2017-201 , andaj sipas projekteve të cekura në reference nuk dëshmohet përvoja e punës 5 vjeçare ne objektet e trashëgimisë kulturore për Ferdeze Sermaxhaj, po ashtu i mungojnë 2 referencat nga punëdhënësi që dëshmojnë dhe mbulojnë përvojën e punës 5 vjeçare në objektet e trashëgimisë kulture.

z. Skender Avdyli është i diplomuar më datën 1988 cili ka marr titullin inxhinier i diplomuari Ndërtimtarisë OE N.P.N. "Idea Project" ka bërë kontratë mbi vepër për projektin në fjalë me z.Avdyli më datën 19/04/2019 Sipas CV se z Avdyli dëshmohet se ka punuar te kompania NT Pleqja nga viti 2011 deri 2017, edhe pse sipas ne CV dëshmohet se ka punuar edhe te NTP Fidani-L-nga viti 2008-2017, që do të thotë nuk është përcaktuar koha e vitit 2017 se ne cilën kompani ka punuar. Sipas Referencës së lëshuar nga kompania Pleqja Company për z Skender Avdyli e cila nuk ka asnjë datë të shënuar se kur është lëshuar kjo reference , të cilët janë përshkruar disa projekte të trashëgimisë kulturore, por mungon informatat ne reference rreth periudhës se kohës se angazhimit të personit Avdyli pranë kompanisë Plega, andaj referenca nuk dëshmon se personi në fjalë ka punuar 5 vite pranë kompanisë Pleqa kompani , gjithashtu nuk janë ofruar për z.Avdyli 2 referenca që dëshmojnë dhe mbulojnë përvojën e punës në objektet restauruese trashëgimisë kulturore të cilët dëshmohet përvoja e punës 5 vjeçare siç është kërkuar në pikën 4.1 FTD nga AK MKRS ku është kërkuar qe 2 referencat nga punëdhënësi te dëshmojnë përvojën e punës 5 vjeçare ne objektet e trashëgimisë ,andaj nuk është plotësuar kriteri i kërkuar nga AK MKRS me z Skender Avdyli.

Ismajl Prekaj, mjeshtër i drurit. sipas Referencës nga OE N.P.N. "Idea Project" me datën 30/08/2018 e cila përshkruhet se ka punuar ne disa projekte te trashëgimisë kulturore gjate vitit 2017 , ndërsa Kontrata e punës e lidhur ne mes OE N.P.N. "Idea Project" dhe z. Ismail Prekaj , Mjeshtër i Drurit është më datën 03/01/2018 deri me datën 31/12/2019, që nuk po përputhet referenca dhe kontrata e punës. Gjithashtu z Prekaj mjeshtër | drurit OE N.P.N. "Idea Project" ka ofruar vetëm një reference nga punëdhënësi ndërsa kërkesa pika 4.1 është kërkuar se paku 2 referenca nga punëdhënësi 2 referenca te punëve te kryera te kësaj natyre (angazhime profesionale ne objektet e Trashëgimisë Kulturore) , andaj nuk është plotësuar kriteri I kërkuar ne FTD nga AK MKRS

Shefqt Haklaj mjeshter i gurit, sipas Referencës nga OE N.P.N. "Idea Project" me datën 30/08/2018 e cila përshkruhet se ka punuar ne disa projekte te trashëgimisë kulturore gjate vitit 2017 , ndërsa Kontrata e punës e lidhur ne mes OE N.P.N. "Idea Project" dhe z. Ismail Prekaj , Mjeshtër guri është me datën 03/01/2018 deri me datën 31/12/2019, qe nuk po përputhet referenca dhe kontrata e punës, gjithashtu z Haklaj mjeshtër | gurit OE N.P.N. "Idea Project" ka ofruar vetëm një reference nga punëdhënësi ndërsa kërkesa pika 4.1 është kërkuar se paku 2 referenca nga punëdhënësi 2 referenca te punëve te kryera te kësaj natyre (angazhime profesionale ne objektet e Trashëgimisë Kulturore) , andaj nuk është plotësuar kriteri i kërkuar ne FTD nga AK MKRS

Neni 1 i LPP-së, vendimin e AK keni shpërblyer OE i cili nuk i ka plotësuar kërkesën e përcaktuar pika Kapaciteti teknik dhe profesional, Andaj qëllimi i neni 1 LPP është qe Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen. Andaj mjetet financiare te buxhetit vetëm duke shpërblyer me kontratë OE i cili është i përgjegjshëm me çmim me te lire.

Neni 6, i LPP-së nuk është efikasitet duke shpërblyer me kontrate ku nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuar ne dosjen e tenderit, pasi qe përveç qe i dëmtoni ne konkurrim , po ashtu ekonomikisht dhe financiarisht OE te cilët janë te përgjegjshëm me çmim me te lire , ju si AK-se bëni vonesa ne realizmin e kontratës.

Neni 7, i LPP-së , AK MKRS duke shpallur fitues OE i cili nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuar ne dosje te tenderit neve si OE ne ketë rast jemi te diskriminuar dhe jo te barabarte si përfitues se kontratës pasi që sipas kritereve te përcaktuar ne dosje te tenderit ne si OE konkurrues jemi te përgjegjshëm me çmim me te lire, andaj keni bere diskriminim dhe jo barazi ndaj neve si OE konkurrues.

Neni 59, i LPP-së, ju si AK MKRS nuk keni vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar procedurën tenderuese te vlerësimit ne pajtim me LPP pasi qe keni shpërblyer me kontrate OE fitues i cili nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuar ne dosjen e tenderit

Neni 60, i LPP-së , ju si AK duke mos respektuar nenin 60 te LPP-se ku përcaktohet ne piken 1.1 te neni 60 se duhet te shpërblehet OE konkurrues i cili i cili është i përgjegjshëm me çmim me te lire, e ne ketë rast ju si AK keni shpërblyer me kontrate OE fitues i cili nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuar ne FTD,

Sipas kontrollimit te paramases dhe parallogarise te cilën e kemi dorëzuar si OE kemi konstatuar se nuk kemi gabime ne llogaritje për Shtëpia e familjes Doda,dhe Shtëpia e familjes Hereni, mund te keni bere ndonjë gabim teknike gjate perpilimit .

Të nderuar/a kërkojmë nga ju gë të zbatoni procedurat dhe dispozitat e LPP-së, sepse jeni të thirrur ta b6ëni këtë gjë dhe mos vazhdoni të na diskriminoni dhe të na dëmtoni, për shkak se ne plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe natyrisht duhet të jemi fitues të kësaj kontrate dhe për të ardhur deri këtu kemi bërë një punë, angazhim dhe mund të madh, dhe kemi bërë shpenzime materiale.

Në vendimin e AK-së të dt:18.04.2019 për refuzim të kërkesës tonë për rishqyrtim asnjë arsye faktike nuk është dhënë në lidhje me pretendimet tona ankimore.

Të nderuar/a kërkojmë nga ju si OSHP, që të detyroni autoritetin kontraktues që të zbatojë procedurat dhe dispozitat e LPP-së, sepse janë të thirrur ta bëjnë këtë gjë, dhe ta detyroni që mos vazhdojnë të na diskriminojnë dhe të na dëmtojnë neve sepse këtë e ndalon neni 7 i LPP-së, për shkak se ne jemi fitues te kësaj kontrate duke i plotësuar kriteret e përcaktuar ne FTD nga AK-se, dhe për të ardhur deri këtu kemi bërë një punë, angazhim dhe mund të madh, dhe kemi bërë shpenzime materiale financiare ,andaj nga ju (OSHP) kërkojmë që ti ushtroni kompetencat ligjore, që të detyroni | autoritetin kontraktues që të respektojë procedurat e prokurimit konform dispozitave të LPP-së.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Albi Company"

ANULOHET, njoftimi për anulim të aktivitetit tç prokurimit dhe të vazhdoni me procedurat e rivlerësimit, sipas dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të FDT-së e të njoftimit për kontratë, në të kundërtën, ne do të jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat e ankimimit në të gjitha instancat tjera në Republikën e Kosovës.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë (në Eprokurim): 29.03.2019

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Kontratë publike kornizë - punë

Vlera e parashikuar e kontratës:..... ..... 100.000,00 €

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave ..... 13.04.2019 koha 14:00

Data e hapjes se ofertave ..... 23.04.2019 koha 14:00

Data e përfundimit te vlerësimit te ofertave 06.06.2019

Data e njoftimit mbi vendimin e AK..... 07.06.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm..... 07.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim 12.06.2019

Data e vendimit të AK –së lidhur me kërkesën për rishqyrtim *18.06.2019*

Data e ankesës në OSHP 27.06.2019

Kriteret për vlerësim:

6.4. Kërkesat e përshtatshmërisë:

1 Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.

2. Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për

pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

3. Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1 Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – Aneksi 2
2. Vërtetim nga Administrata Tatimore
3.Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – origjinal kopje e noterizuar Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.

7.1 & 72 Kërkesat e Përshtatshmërisë profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës)
2. Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore)
3. Certifikata e numrit fiskal (vetëm për kompanitë vendore.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit te biznesit
2. Kopja e certifikatës së TVSH-së
3. Kopja e certifikatës së numrit fiskal

8.1 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

n/a

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

n/a

9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. OE duhet te dëshmoje se ka realizuar kontrata gjate periudhës se shkuar trevjeçare nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne lëmine e objekteve te ndërtimeve ,restaurimeve dhe punëve te ngjashme
2. Listën për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike në dispozicion për ndërtimin e objektit që kompania duhet t'i ketë në pronësi ose të ketë kontratë mbi shfrytëzimin e tyre.
1. Kamion

2. Skele

3. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj minimumin e kapacitetit të fuqisë punëtore të kompanisë me të dhënat në vijim Emri, mbiemri, mosha punëtorit, profesioni, eksperienca dhe pozicioni në kompani.

4. Ne listën e stafit te prezantojë -2(DY) Inxhinier te diplomuar te Arkitekturës, me min 5 vite përvoje pune ne angazhime profesionale ne objektet e trashëgimisë kulturore (sistem pese vjeçar ose master) - 1Një Inxhinier të Ndërtimtarisë-Drejtimi Konstruktiv, min. 5 vite përvojë. (sistem pese vjeçar ose master)

- Mjeshtrin e punëve te drurit --- -Mjeshtërinë e punëve te gurit

5.OE duhet te dëshmojnë se janë te certifikuar me ISO 9001 2015

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Listen me te cilen specifikohen te gjitha projektet e puneve te realizuara ne periudhen e shkuar trevjeçare te percjella me Kontrata ne objektet restauruese , raporte te pranimit teknik apo referenca min nje, ku percaktohet nr.prokurimit, vlera data e nenshkrimit, Autoriteti Kontraktues.-Origjinal e vulosur dhe nenshkruar

2.Lista e pajisjeve të dorëzohet në origjinal e vulosur dhe nenshkruar bashkengjitur me dokumente valide te regjistrimit ose nëse janë me qira Marrëveshje e Vlefshme për shfrytëzimin e Makinerisë

3.-Një pasqyrë tabelare e personelit të kërkuar Emrin,mbiemrin ,mosha e punëtorit,profesioni i kërkuar si dhe eksperienca duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.

4.1.Inxhinierat e Arkitektures dhe inxh e ndertimtarise te posedojne Diplomën, CV-ja e përshkruar qarte me eksperiencën e kërkuar, e nënshkruar dhe referencat,kopja e kontratës së punës e vlefshme para kontratë, si dhe 2 referencat ne objektet restauruese qe deshmojne pervojen e kerkuar 5 vjeçare - Mjeshtri i puneve te drurit te dokumentohen me kontrata parakontrata dhe 2 referenca te puneve te kryera te kesaj natyre (angazhime profesionale ne objektet e Trashegimise Kulturore) -Mjeshtri puneve te gurit te dokumentohen me me kontrata parakontrata dhe 2 referenca te puneve te kryera te kesaj natyre (angazhime profesionale ne objektet e Trashegimise Kulturore)

Vërejtje stafi professional, Inxh. arkitektures nuk pranohen me Bachelor

5.OE duhet te dëshmojnë se janë te certifikuar me ISO 9001 2015;

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Çmimi € me TVSH	Vërejtje
1.	"ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc, Suhareke, GREJKOVC	79,959.38	JO
2.	N.P.N. " IDEA - PROJECT " Rr. Sali Geku P.N., DECAN	85,339.06	JO
3.	"ALBI COMPANY" SH.P.K Sylejman Vokshi pn, RAHOVEC	89,437.00	JO

4.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. TONI ; „Benita Company Sh.p.k. KARVASARI, MALISHEVE	89,785.12	JO
5.	Ridvan Elezi B.1. Pellazgët 18A, Prizren	93,636.88	JO
6.	N.T." Pleqja " Isniq, Deqan	94,864.86	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.
Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Kujtesa Godeni – Kryetar i komisionit
- Ardiana Qorraj – Anëtar i komisionit
- Nushe Mekuli – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

- Në bazë të kritereve të përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dokumentacionit tenderues, komisioni për vlerësimin e ofertave i emëruar me vendimin me nr. 1708/2019 i datës 06 .05.2019 për vlerësimin e tenderit RI-TENDERIM MASAT PREVENTIVE-INTERVENIME EMERGJENTE NE OBJEKTE SHTEPI NE PRIZREN: Shtëpia e Familjes Dukagjini, Muriqi, Hereni, Koci, Kolshi, Skenderi, Doda dhe Lokvica, pas procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve konstatoi:
- Ridvan Elezi - "ALFA ING" B.I. Pellazgët 18A, 20000, PRIZREN — 93.636,88 € - : Operatori Ekonomik i përgjegjshëm si nga ana administrative ashtu edhe nga ana tekniko-profesionale.

- "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc, SUHAREKE, 23000, GREJKOVC — 79.959,38 € - Operatori i përgjegjshëm si nga ana administrative ashtu edhe nga ana tekniko-profesionale.

- Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.P. TONI ; „ BENITA COMPANY" Sh.p.k.,KARVASARI, 24000, MALISHEVE - 89.785,12 € -: Operatori Ekonomik 1 përgjegjshëm si nga ana administrative ashtu edhe nga ana tekniko-profesionale, pas verifikimit të kalkulimeve ka pasur gabime aritmetikore tek llogaritja e paramases - Shtëpia e Familjes Hereni - Prizren ku shuma totale është 18,336.75 € e jo 18,384.75 €.

- "ALBI COMPANY" SH.P.K, Sylejman Vokshi pn, - RAHOVEC — 89.437,00 € - : Operatori i përgjegjshëm si nga ana administrative ashtu edhe nga ana tekniko-profesionale, pas verifikimit të kalkulimeve ka pasur gabime aritmetikore tek llogaritja e paramases - Shtëpia e Familjes Doda - Prizren ku shuma totale është 12,743.00 € e jo 13,793.00 €.

- N.T. " PLEQJA ", Isniq, 51000, DECAN, - 94.864,86 € -: Operatori i përgjegjshëm si nga ana administrative ashtu edhe nga ana tekniko- profesionale.

- N.P.N. " IDEA - PROJECT ", Rr. Sali Geku P.N., 51000, DECAN - 85.339,06 € - : Operatoir i përgjegjshëm nga ana administrative, por nga ana tekniko-profesionale tek stafi 1 prezantuar për Inxhinierin e Arkitekturës Fatos Sahatqija nuk janë prezantuar CV dhe Referencat..

Analiza dhe sqarimet-përgjigje e ekspertit shqyrtues (Neni 113, 114).

Tenderuesi Ankues, "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci", deklaron se nuk pajtohet me vendimin e publikuar nga AK, MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK të datë 07.06.2019. Mendojmë se AK ka bërë gabim gjate vlerësimit të tenderit.

Dispozitat e shkelura sipas tenderuesit ankues "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci", janë:

Nenit 1, *Qëllimi*

Nenit 6, *Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*

Nenit 7, *Barazia në trajtim/Jo diskriminimi*

Neni 59, *Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi* dhe

Neni 60, *Kriteret pre Dhënien e Kontratës*

1. Tenderuesi i shpallur FITUES ALBOOS, SUHAREKE :

Eksperti shqyrtues pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar si dhe duke marr parasysh se këto nene të lartë cekura nga Tenderuesi ankues ne ankesë, sqarojmë me sa vijon:

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 1)*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (***Qëllimi***) është i bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin e papërgjegjshëm "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc veprim që nuk është në pajtueshmëri me Nenin 1 të LPP-së, sepse citojmë :

1. *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.*
2. *Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*
3. *Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.*

<u>Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (*Neni 6*)</u>.

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (***Ekonomiciteti dhe Efikasiteti***) <u>është i bazuar</u>, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin e papërgjegjshëm "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc, veprim ky që nuk është në pajtueshmëri me Nenin 6 të LPP-së, sepse citojmë :

1. *Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit*

<u>Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (*Neni 7*)</u>

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (**Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**) <u>është i bazuar</u>, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin e papërgjegjshëm, që është në kundërshtim me Nenin 60 të LPP,

Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:
1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së Tenderuesit "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc fitues për këtë kontratë ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, duke favorizuar ofertën e këtij operatori i cili sipas vlerësimit nga ana ime <u>është i papërgjegjshëm</u> dhe duke diskriminuar operatoret tjerë pjesëmarrës në tender. Me këtë rast nuk e ka trajtuar në mënyrë të barabartë tenderuesin Ankues, "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci" edhe pse ka ofruar

tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët prej 89.437,00 €.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 7)*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (**Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**) është i bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues nuk e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm me çmim më të lirë në pajtueshmëri me Nenin 60 të LPP,

Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:
1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së Tenderuesit "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc fitues për këtë kontratë ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, duke favorizuar ofertën e këtij operatori i cili sipas vlerësimit nga ana ime është i papërgjegjshëm dhe duke diskriminuar operatoret tjerë pjesëmarrës në tender. Me këtë rast nuk e ka trajtuar në mënyrë të barabartë tenderuesin Ankues, "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci" edhe pse ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët prej 89.437,00 €.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur *(Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i bazuar, sepse duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, në pajtim me **nenin 59 par.** 4 të LPP-së, po citoj: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".*

- Duke e shpallur fitues tenderin e tenderuesit "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc ka vepruar në kundërshtim me **nenin 59**, paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se ne Republikën e Kosovës, sepse nga kontrollimi i tenderit të këtij tenderuesi kam konstatuar se ky tenderues nuk është i përgjegjshëm, sepse nuk e ka plotësuar nenin 69 të LPP, *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale* (Nr. i Nenit *9.1 & 9.2*) Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) faqe 14, 15 në Dosje të Tenderit.

AK ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne FDT te dosjes se tenderit ne paragrafin; 9.1 & 9.2 pika 3 dhe 4 ka kërkuar:

Kërkesat mbi	9.1 &	**Kapaciteti teknik dhe professional:**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.2	3. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj minimumin e kapacitetit të fuqisë punëtore të kompanisë me të dhënat në vijim Emri,mbiemri,mosha punëtorit,profesioni,eksperienca dhe pozicioni në kompani. 4. Ne listen e stafit te prezentoje - 2(DY) Inxhiner te diplomuar te Arkitektures, me min 5 vite pervoje pune ne angazhime profesionale ne objektet e trashegimise kulturore (sistem pese vjeçar ose master) - 1Një Inxhinier të Ndërtimtarisë-Drejtimi Konstruktiv, min. 5 vite përvojë. (sistem pese vjeçar ose master) - Mjeshtrin e puneve te drurit ---- Mjeshtrine e puneve te gurit	3.-Një pasqyrë tabelare e personelit të kërkuar Emrin,mbiemrin ,mosha e punëtorit, profesioni i kërkuar si dhe eksperienca duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. 4.1.Inxhinierat e Arkitektures dhe inxh e ndertimtarise te posedojne Diplomën, CV-ja e përshkruar qarte me eksperiencën e kërkuar, e nënshkruar dhe referencat,kopja e kontratës së punës e vlefshme para kontratë, si dhe 2 referencat ne objektet restauruese qe deshmojne pervojen e kerkuar 5 vjeçare -Mjeshtri i puneve te drurit te dokumentohen me kontrata parakontrata dhe 2 referenca te puneve te kryera te kesaj natyre (angazhime profesionale ne objektet e Trashegimise Kulturore) -Mjeshtri puneve te gurit te dokumentohen me me kontrata parakontrata dhe 2 referenca te puneve te kryera te kesaj natyre (angazhime profesionale ne objektet e Trashegimise Kulturore) Vërejtje stafi professional, Inxh. arkitektures nuk pranohen me Bachelor

Gjatë kontrollimit të tenderit dhe dëshmive të dorëzuara, të tenderuesit "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc në tenderin e tij, kamë konstatuar se nuk ka dorëzuar *Dëshmi të mjaftueshme të kërkuar dokumentare,* (për stafin, 2 (DY) Inxhinier te diplomuar te Arkitekturës dhe 1 (Një) Inxhinier të Ndërtimtarisë-Drejtimi Konstruktiv) :

- Për pozitën e **Inxhinier te diplomuar te Arkitekturës**, "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc në tender ka bashkangjitur dokumentacion për **Bujar PRESTRESHI**, i cili në bazë të dëshmive të dorëzuara ne tender nuk i plotëson kërkesat e kërkuara nga AK, dmth është i papërgjegjshëm për pozitën e kërkuar nga AK.

Ing. Bujar Prestreshi, fare nuk është i përfshirë në Listën e stafit të prezantuar nga ky tenderues i shpallur fitues.

Tenderuesi i shpallur fitues ka bërë kontratë mbi vepër për projektin në fjalë me ing. Bujar Prestreshi më datën 23/04/2019, i cili është i diplomuar më datën 11/04/2005 i cili ka marr titullin inxhinier i diplomuar i Arkitekturës.

Në CV e dorëzuar për ing. Bujar Prestreshi nuk është e përshkruar qartë me eksperiencën e kërkuar siç është kërkuar në pikën 4.1, pasi që në CV-in e dorëzuar nuk përshkruhet asgjë për projektet e trashëgimisë kulturore se në cilët projekte të trashëgimisë ka punuar, në bazë të dëshmive të dorëzuara ne tender nuk i plotëson kërkesat e kërkuara nga AK.

Nga dokumentacioni-dëshmitë e dorëzuara për Ing. Bujar Prestreshi, shihet se nuk ka 2 referenca që dëshmojnë përvojën e punës 5 vjeçare në objektet restauruese të trashëgimisë kulturore siç është kërkuar *në njoftimin e kontratë dhe në dosjen e tenderit.*

Në CV-in e z Bujarit është shënuar se ka punuar në Swedish NGO ChwB në vitin 2002-2007 por nuk ka të dhëna se në cilat projekte ka punuar në objektet e trashëgimisë kulturore, gjithashtu shihet se z.Bujari ka diplomuar më datën 11/04/2005 që do të thotë nga viti 2002-2005 nuk e ka pasur titull Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës, andaj përvoja e punës nuk është e pranueshme si përvojë e punës nga viti 2002-2005 pasi që nuk e ka pasur titullin e fituar të Inxhinier i Arkitekturës bazuar me ligjet ne Kosovë.
Ing. Bujari, ka përvojë punë në objektet e trashëgimisë vetëm 2 vite pas marrjes se titullit te Inxhinierit te Arkitekturës Referencat tjera të përvojës së punës të dorëzuar për z Bujar nuk janë referenca që dëshmojnë përvojën e punës minimumi 5 vjeçare në objektet e trashëgimisë kulturore.

- Për pozitën e **Inxhinier te diplomuar te Arkitekturës**, "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc në tender ka bashkangjitur dokumentacion për Ing. **Isuf HOXHA**, i cili në bazë të dëshmive të dorëzuara ne tender nuk i plotëson kërkesat e kërkuara nga AK, dmth është i papërgjegjshëm për pozitën e kërkuar nga AK.

Isuf Hoxha me diplomë Master profesional ne Dizajn Urban dhe Peizazhi të lëshuar më datën 07/12/2017,

z.Isuf Hoxha fare nuk është i përfshirë në Listën e stafit të prezantuar nga ky tenderues i shpallur fitues. Isuf Hoxha me diplomë Master profesional ne Dizajn Urban dhe Peizazhi të lëshuar më datën 07/12/2017, ndërsa në CV-in e z Hoxha nuk ka të dhëna rreth diplomimit në Universitetin e Prishtinës Fakulteti Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.

Në CV-ja e dorëzuar për Ing. Hoxha nuk është përshkruar qartë me eksperiencën e kërkuar siç është kërkuar në pikën 4.1, pasi që në CV-in e dorëzuar nuk përshkruhet asgjë për projektet e trashëgimisë kulturore të cilën z Hoxha ka punuar në projekt të trashëgimisë kulturore, andaj tenderuesi i shpallur fitues nuk plotësuar kriterin e kërkuar nga AK përmes njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit.

Isuf Hoxha, profesional ne Dizajn Urban dhe Peizazhi, nuk ka 2 referenca që dëshmojnë dhe mbulojnë përvojën e punës 5 vjeçare në objektet restauruese apo të trashëgimisë kulturore siç është kërkuar në kërkesat në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit nga AK.

- Për pozitën e Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë Konstruktive, "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc në tender ka bashkangjitur dokumentacion për **Xhevdet Buqa**, i cili në bazë të dëshmive të dorëzuara ne tender nuk i plotëson kërkesat e kërkuara nga AK, dmth është i papërgjegjshëm për pozitën e kërkuar nga AK.

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit-dëshmive të dorëzuara për Ing. Xhevdet Buqa, me titull Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë Konstruktive i diplomuar me 12/07/2006 i punësuar me kontratë të rregull e lidhur në mes palëve më dt. 28/04/2016 dhe sipas përshkrimit të CV–së është që z Buqaj punon në kompaninë Alboss nga viti 2011 dhe

vazhdon të jetë i punësuar.

Sipas Referencës së lëshuar nga Alboss nuk ka informata se cilën periudhë ka punuar Xhevdet Buqa në këtë kompani, Në reference janë përshkruar këto projekte që Xhevdet Buqa ka punuar :

- Restaurimi i kompleksit te Lidhjes Shqiptare te Prizrenit e lidhur me datën 18/05/2018 nr. 89- 9/2018 dhe vlera 38.444.00 € me QRTK, Prizren, dhe referenca e lëshuar me dt. 17/12/2018.
- Restaurimi i shtëpisë se familjes Shpejti (Fasadimi i objektit) e lidhur me datën 26/04/2018 nr. 155/2018 me vlere 7,848.40 € me QRTK, Prizren dhe Referenca e lëshuar me dt. 17.12.2018.
- Masat preventive-Ndërhyrjet emergjente Objekti Shtëpia e familjes Drini faza I, e lidhur 19/10/2017 me nr. 357/2017 ne vlerë 8,982.50 €, me QRTK Prizren dhe Referenca e lëshuar me datën 17/12/2018.
- Masat preventive-Ndërhyrjet emergjente Objekti Shtëpia e familjes Ukallo, e lidhur 19/10/2017 me nr. 357/2017 ne vlerë 9,995.70 €, me QRTK Prizren dhe Referenca nuk ka për këtë projekt.

Sipas të dhënave të kontratave dhe referencave të projekteve të realizuar nga tenderuesi i shpallur fitues "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc, vërtetohet se ka realizuar kontrata të natyrës së trashëgimisë kulturore në vitet 2017 dhe 2018 Andaj projektet e cekura në reference nga Alboss për Xhevdet Buqa dhe sipas listës së projekteve dhe kontratave dhe reference të dorëzuar në dosjen e tenderit të "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc dëshmohet se ka përvojë punë vetëm 1 apo 2 vite në projekt e trashëgimisë kulturore

Andaj për Xhevdet Buqa, nuk ka 2 referenca që dëshmojnë dhe mbulojnë përvojën e punës 5 vjeçare në objektet restauruese apo të trashëgimisë kulturore siç është kërkuar në kërkesat në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit nga AK.

Gjatë kontrollimit të tenderit dhe dëshmive të dorëzuara, të tenderuesit "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc në tenderin e tij, kamë konstatuar se nuk qendron konstatimi i ankusit se **Isuf Dakaj, mjeshtër i gurit dhe Shaban Thaci, mjeshtër latues,** janë të papërgjegjshëm, kinse për këto pozita kanë të dëshmuar vetëm me nga një referencë të lëshuar nga tenderuesi "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc më datën Prizren 2019, ndërsa në kërkesën 4.1 nga AK-se MKRS është kërkuar 2 referenca të punëve të kryera të kësaj natyre (Angazhime profesionale ne objektet e trashëgimisë kulturore.

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit-dëshmive të dorëzuara për **Isuf Dakaj, mjeshtër i gurit ka** kontratë të rregullt pune më datën 28/04/2019, ka të dëshmuar vetëm një referencë të lëshuar nga tenderuesi "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc më datën Prizren 2019, mirëpo në këtë referencë janë të përfshira 5 projekte të ndryshme për të cilat ka kontrata në vete për punë të kryera të kësaj natyrë (Angazhime profesionale në objektet e trashëgimisë kulturore.

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit-dëshmive të dorëzuara për **Shaban Thaci, mjeshtër latues** kontratë të rregullt më datën 28/04/2019, ka të dëshmuar vetëm një referencë të lëshuar nga tenderuesi "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc më datën Prizren 2019, mirëpo në këtë referencë janë të përfshira 5 projekte të ndryshme për të cilat ka kontrata në vete për punë të kryera të kësaj natyrë (Angazhime profesionale në objektet e trashëgimisë kulturore.

- Autoriteti Kontraktues në letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm për "Albi Company" shpk, se ka pasur gabime aritmetike tek llogaritja e para masës te Shtëpia e familjes Doda, Prizren, nuk qëndron, sepse me kontrollimin dhe llogaritjen aritmetike të ofertës financiare, të cilën e ka dorëzuar "Albi Company" shpk kam konstatuar se nuk ka gabime ne llogaritje.

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (*Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës)*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, se nuk është zbatuar si duhet Nenin 60 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve (*Kriteret për Dhënien e Kontratës*) është i bazuar, sepse nuk është respektuar ky nen ku kërkohet (*citojmë*) :

LPP ne nenin 60 paragrafi 1.dhe nen paragrafin 1.1 përcakton:

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:
1.1 tenderin ë përgjegjshëm me çmimin më të ulët:

Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam shqyrtuar, analizuar dhe krahasuar dhe në atë që u tha më lartë në këtë raport, Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 60, duke e shpallur tenderuesin e pa përgjegjshëm fitues, tenderuesin "ALBOSS"SH.P.K. Grejkoc.

2. Tenderuesi i dytë i radhitur sipas çmimit NPN IDEA PROJECT - DEÇAN

Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (*Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)*

Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, është i bazuar, sepse duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, në pajtim me **nenin 59 par**. 4 të LPP-së, po citoj: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".*

Duke e shpallur fitues tenderin e Tenderuesit N.P.N. "Idea Project", të përgjegjshëm, AK ka vepruar në kundërshtim me **nenin 59**, paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se ne Republikën e Kosovës, sepse nga kontrollimi i tenderit të këtij tenderuesi kam konstatuar se ky tenderues nuk është i përgjegjshëm, sepse nuk e ka plotësuar nenin 69 të LPP, *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale* (Nr. i Nenit *9.1 & 9.2*) Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) faqe 14, 15 në Dosje të Tenderit.

AK ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne FDT te dosjes se tenderit ne paragrafin; 9.1 & 9.2 pika 3 dhe 4 ka kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** 3. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj minimumin e kapacitetit të fuqisë punëtore të kompanisë me të dhënat në vijim Emri,mbiemri,mosha punëtorit,profesioni,eksperienca dhe pozicioni në kompani. 4. Ne listen e stafit te prezentoje - 2(DY) Inxhiner te diplomuar te Arkitektures, me min 5 vite pervoje pune ne angazhime profesionale ne objektet e trashegimise kulturore (sistem pese vjeçar ose master) - 1Një Inxhinier të Ndërtimtarisë-Drejtimi Konstruktiv, min. 5 vite përvojë. (sistem pese vjeçar ose master) - Mjeshtrin e puneve te drurit --- - Mjeshtrine e puneve te gurit	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 3.-Një pasqyrë tabelare e personelit të kërkuar Emrin,mbiemrin ,mosha e punëtorit, profesioni i kërkuar si dhe eksperienca duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. 4.1.Inxhinierat e Arkitektures dhe inxh e ndertimtarise te posedojne Diplomën, CV-ja e përshkruar qarte me eksperiencën e kërkuar, e nënshkruar dhe referencat,kopja e kontratës së punës e vlefshme para kontratë, si dhe 2 referencat ne objektet restauruese qe deshmojne pervojen e kerkuar 5 vjeçare -Mjeshtri i puneve te drurit te dokumentohen me kontrata parakontrata dhe 2 referenca te puneve te kryera te kesaj natyre (angazhime profesionale ne objektet e Trashegimise Kulturore) -Mjeshtri puneve te gurit te dokumentohen me me kontrata parakontrata dhe 2 referenca te puneve te kryera te kesaj natyre (angazhime profesionale ne objektet e Trashegimise Kulturore) Vërejtje stafi professional, Inxh. arkitektures nuk pranohen me Bachelor

Gjatë kontrollimit të tenderit dhe dëshmive të dorëzuara, të tenderuesit N.P.N. "Idea Project", në tenderin e tij, kamë konstatuar se nuk ka dorëzuar *Dëshmi të mjaftueshme të kërkuar dokumentare,* (për stafin, 2 (DY) Inxhinier te diplomuar te Arkitekturës dhe 1 (Një) Inxhinier të Ndërtimtarisë-Drejtimi Konstruktiv) :

- Për pozitën e **Inxhinier te diplomuar te Arkitekturës**, N.P.N. "Idea Project", në tender ka bashkangjitur dokumentacion për **Fatos Sahatqija**, i cili në bazë të dëshmive të dorëzuara ne tender nuk i plotëson kërkesat e kërkuara nga AK, dmth është i papërgjegjshëm për pozitën e kërkuar nga AK.

Ing. **Fatos Sahatqija**, nga dëshmitë e dorëzuara shihet se ka diplomuar me 24/06.1989 dhe ka marre titullin inxhinjer i Arkitekturës. Tenderuesi NPN "Idea Project", ka bërë kontratë

mbi vepër për projektin në fjalë me Sahatqija më datën 19/04/2019.

Mirëpo për Ing. Ark. Fatos Sahatqija, në tenderin e tenderuesit N.P.N. "Idea Project", fare nuk është bashkangjitur dhe nënshkruar CV-ja, ku përshkruhet qartë eksperiencën e tijë. Gjithashtu nuk janë dëshmuar fare 2 referenca, nga punëdhënësi në objektet restauruese, që dëshmojnë përvojën e kërkuar 5 vjeçare në objektet e trashëgimisë kulturore siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, andaj Ing. Ark. Fatos Sahatqija është i papërgjegjshëm.

- Për pozitën tjetër, **Inxhinier te diplomuar te Arkitekturës**, tenderuesi N.P.N. "Idea Project", në tender ka bashkangjitur dokumentacion për Ing. **Ferdeze Sermaxha,** e cila është i diplomuar më datën 23/05/2008 e cila ka marr titullin inxhinier i diplomuar i Arkitekturës tenderuesi N.P.N. "Idea Project" ka kontrate mbi vepër për projektin në fjalë me Sermaxhaj më datën 19/04/2019 Sipas CV -së Ferdeze Sermaxha e cila është përshkruar se punon te N.P.N. "Idea Project" nga viti 2015 dhe ka punuar në këto projekte dhe sipas referencës së lëshuar nga tenderuesi N.P.N. "Idea Project" më datën 03/05/2018 :
  - Kulla e Salih Kajtazit, Kçiçi i Vogel dhe Kulla e Asilan Tupella Kçiçi i Vogel, viti 2017, vlera e kontratës 24,973.57 €
  - Objekti-Shtëpia e banimit Mirsad Ferati, viti 2017, vlera e kontratës 11,440.08 €
  - Objekti Sahat Kulla – Gjilan, viti 2017, vlera e kontratës 33,236.61 €,

Sipas Projekteve të cekura në CV dhe Referencën e lëshuar punëdhënësi N.P.N. "Idea Project" po konstatohet se Ferdeze Sermaxha nuk ka dëshmi, se ka përvojë pune 5 vjeçare ne objektet e trashëgimisë kulturore, pasi që sipas projekteve të cekur dhe listës së kontratave te tenderuesi N.P.N. "Idea Project", janë te realizuar gjate vitit 2017, andaj sipas projekteve të cekura në reference nuk dëshmohet përvoja e punës 5 vjeçare ne objektet e trashëgimisë kulturore për Ferdeze Sermaxhaj dhe e njëjta është e papërgjegjshme.

- Për pozitën e Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë Konstruktive, tenderuesi N.P.N. "Idea Project", në tender ka bashkangjitur dokumentacion për Ing. **Skender Avdyli,** i cili në bazë të dëshmive të dorëzuara ne tender nuk i plotëson kërkesat e kërkuara nga AK, dmth është i papërgjegjshëm për pozitën e kërkuar nga AK. Në listën e punëtorëve tenderuesi e ka paraqitur gabimisht Inxhinier te diplomuar te Arkitekturës.

Ing. Skender Avdyli, është i diplomuar më datën 1988 cili ka marr titullin inxhinier i diplomuari i Ndërtimtarisë. Tenderuesi N.P.N. "Idea Project" ka bërë kontratë mbi vepër për projektin në fjalë me z.Avdyli më datën 19/04/2019. Sipas CV se z Avdyli dëshmohet se ka punuar te kompania NT Pleqja nga viti 2011 deri 2017 edhe pse sipas ne CV dëshmohet se ka punuar edhe te NTP Fidani-L-nga viti 2008-2017, që do të thotë nuk është

përcaktuar koha e vitit 2017 se ne cilën kompani ka punuar.

Sipas Referencës së lëshuar nga kompania Pleqja Company për Skender Avdyli, e cila nuk ka asnjë datë të shënuar se kur është lëshuar kjo reference, të cilët janë përshkruar disa projekte të trashëgimisë kulturore, por mungon informatat ne reference rreth periudhës se kohës se angazhimit të personit Avdyli pranë kompanisë Pleqja, andaj referenca nuk dëshmon se personi në fjalë ka punuar 5 vite pranë kompanisë Pleqja kompani. E referenca e lëshuar nga tenderuesi N.P.N. "Idea Project", tregon përvojën nji vjeqare, pasi projektet e cekura në këtë referencë-listë, janë te realizuar gjate vitit 2017.

Nga dëshmitë e dorëzuara në tender shihet se nuk janë ofruar për Ing. Skender Avdyli, 2 referenca <u>që dëshmojnë dhe mbulojnë përvoja e punës 5 vjeçare</u> në objektet restauruese trashëgimisë kulturore, siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, andaj i njëjti është i papërgjegjshëm.

- Për pozitat, **<u>Mjeshtrin e punëve te drurit dhe Mjeshtrin e punëve te gurit</u>**, tenderuesi N.P.N. "Idea Project", në tender ka bashkangjitur dokumentacion për **Ismajl Prekaj, mjeshtër i drurit dhe Shefqet Haklaj mjeshtër i gurit.**

  Gjatë kontrollimit të tenderit dhe dëshmive të dorëzuara, të tenderuesit N.P.N. "Idea Project", në tenderin e tij, kamë konstatuar se nuk ka dorëzuar *Dëshmi të mjaftueshme të kërkuar dokumentare,* për këto dy pozita, nuk i plotësojnë kërkesat e kërkuara nga AK, dmth janë të papërgjegjshëm për pozitat e kërkuara nga AK.

Referencat e lëshuara nga tenderuesi N.P.N. "Idea Project", për **Ismajl Prekaj, mjeshtër i drurit** dhe **Shefqet Haklaj mjeshtër i gurit** janë të dyja, me datën 30/08/2018 e cila përshkruhet se ka punuar ne disa projekte te trashigimise kulturore gjate vitit 2017 , ndërsa Kontrata e punës e lidhur ne mes N.P.N. "Idea Project" dhe Ismail Prekaj-Mjeshter i Drurit dhe Shefqt Haklaj-mjeshter i gurit janë më datën 03/01/2018 deri me datën 31/12/2019, që do të nuk po përputhen referenca dhe kontratat e punës.

Shkeljet e konstatuara të LPP –së :

Pas këtyre argumenteve të prezantuara përmes këtij raporti, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet e tenderuesit ankues, "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci", se Autoriteti Kontraktues <u>ka</u> shkelur nenet 1, 6, 7, 56, dhe 60 LPP, <u>janë të qëndrueshme</u> dhe tenderiët e tenderuesit të shpallur fitues "ALBOSS"SH.P.K. nga Suhareka dhe tenderuesit të radhitur i dyti për nga çmimi në hapje të tenderëve, N.P.N. "Idea Project" nga Deçani, <u>janë të papërgjegjshëm</u> .

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, që ankesa e Tenderuesit ankues "ALBI COMPANY" shpk nga Rahoveci", të aprovohet e bazuar (për arsyen që u cek më lart), njëherësh propozoj që të anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**.